



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3481 Prot

Ballsh, më 03.07.2026

VENDIM

Nr. 28 Datë 30/06 2026

“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z. Tajar Shehaj, banorë i fshatit Çërril e Re, Njësia Administrative Selitë, Bashkia Mallakastër, banesa 1 (një) katëshe e të cilit është dëmtuar si pasojë e një zjarri rënë më datë 18.06.2026”.

Baza ligjore

- Ligji Nr.139/2015 date, 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore".
- Ligji Nr.107/2016 date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut".
- Ligji Nr.45, date 18.07.2019 "Per Mbrojtjen Civile".
- V.K.M. nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat dhënies se ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesit natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër për mbështetje financiare të qytetarit **Tajar Shehaj**, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë e zjarrit të rënë më datë 18.06.2026.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar nga ana e Bashkisë Mallakastër.
3. Miratimin e vlerës totale prej **540700 (pesëqind e dyzetë e shtatëqind) lekë**. dëme në orëndi shtëpiake.

Miratimin e vlerës në masën prej **50 %,583665 (pesëqind e tetëdhjetëetremijë e gjashtëqindë e gjashtëdhjetëepesë)lekë**, e vlerës totale prej **1167331(njëmijlione**

njëqinde gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e një) lekë, dëme nga ana ndërtimore.

Totali i vlerës (nga ana e orendive shtëpiake + 50 % nga ana ndërtimore pa TVSH) është 856.257(tetëqind e pesëdhjetëegjashtë mijë e dyqind e pesëdhjet e shtatë) leke.

4. Vlera e dëmit është përlogaritur nga Komisioni i Vleresimit të dëmeve, i ndryshuar të Bashkisë Mallakastër, ngritur me Urdhër nr.375 datë 11.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.
5. Bazuar në ligjin 45, datë 18.07.2019 neni 41 “E drejta e kompesimit”, pika 2, në të cilën thuhet “Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile.
6. Ndhima financiare për familjen e qytetarit Tajar Shehaj përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat dhenies se ndihmes shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Bazuar ne përputhje me çmimet aktuale mesatare të investiguara nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier “Çmimet e investiguara për mobilje, elektroshtëpiake, çmimet sipas zërave të punës nga ana ndërtimore”.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

